



IOM International Organization for Migration  
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

## **PAKETË INFORMUESE PËR POLONINË**

### **1. Informacion bazë**

Kryeqyteti: Varshavë  
Popullsia: 38,530,000  
Sipërfaqja: 312,685 km<sup>2</sup>  
Gjuha: Polake  
Monedha: zloti polak (PLN)  
Niveli i papunësisë: 8%

### **2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe informacion për vizat**

Vizat mund të lëshohen nga misionet diplomatike dhe zyrat konsullore në Republikën e Polonisë.

Embassy of Poland in Tirana, **Albania** (Ambasada e Polonisë në Tiranë, Shqipëri)  
Rruga e Durrësit 123, Tirana  
tel: (0-0355-4) 234-190  
fax: (0-0355-4) 233-364  
e-mail: [polemb@albaniaonline.net](mailto:polemb@albaniaonline.net)  
faqja elektronike: [www.tirana.polemb.net](http://www.tirana.polemb.net)

Embassy of Poland in Sarajevo, **Bosnia & Herzegovina** (Ambasada e Polonisë në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë)  
13 Dola St, 71000 Sarajevo  
tel: (00-387 33) 201 142; 215 862  
fax: (00-387 33) 233 796  
e-mail: [amsar@bih.net.ba](mailto:amsar@bih.net.ba) ; [amsar1@bih.net.ba](mailto:amsar1@bih.net.ba)  
faqja elektronike: [www.sarajewo.polemb.net](http://www.sarajewo.polemb.net)

Embassy of Poland in Zagreb, **Croatia** (Ambasada e Polonisë në Zagreb, Kroaci)  
3 Krležin Gvozd Street, 10000 Zagreb  
tel: (00-3851) 48 99 444  
fax: (00-3851) 48 34 577  
e-mail: [ambasada-polska@zg.t-com.hr](mailto:ambasada-polska@zg.t-com.hr)  
faqja elektronike: [www.zagrzeb.polemb.net](http://www.zagrzeb.polemb.net)

Consular section in Zagreb (Seksioni konsullor në Zagreb)  
3 Krležin Gvozd Street, 10000 Zagreb  
tel: (00-3851) 48 99 414  
fax: (00-385) 48 99 420  
e-mail: [ambasada-polska@zg.t-com.hr](mailto:ambasada-polska@zg.t-com.hr)

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



Federal Office  
for Migration  
and Refugees



GOVERNMENT  
OF LIECHTENSTEIN

Embassy of Poland in Skopje, **the former Yugoslav Republic of Macedonia** (Ambasada e Polonisë në Shkup, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë)  
50 Djuro Djaković Street, 1000 Skopje  
tel: (00-389 2) 31 19 744, 31 12 647  
fax: (00-389 2) 31 33 057  
e-mail: [ambpol@unet.com.mk](mailto:ambpol@unet.com.mk)  
faqja elektronike: [www.ambpol.org.mk](http://www.ambpol.org.mk)  
Seksioni Konsullor  
tel/fax: (00-389 2) 313 30 57

Embassy of Poland in Podgorica, **Montenegro** (Ambasada e Polonisë në Podgoricë, Mali i Zi)  
72, 8 Marta St., 81000 Podgorica  
tel: (00-382) 81 662 442, 81 662 394  
fax: (00-382) 81 662 397

Embassy of the Republic of Poland in Belgrade, **Serbia** (Ambasada e Republikës së Polonisë në Beograd, Serbi)  
Kneza Milosa 38, 11000 Belgrade  
tel: (00-381 11) 206 53 01, 206 53 18, 206 53 22  
fax: (00-381 11) 361 75 76  
e-mail: [Ambrprfj@Eunet.yu](mailto:Ambrprfj@Eunet.yu)  
Seksioni Konsullor  
tel: (00-381 11) 206 53 16, 206 53 17, 206 53 14  
fax: (00-381 11) 361 69 39  
Seksioni Ekonomik  
tel /fax: (00-381 11) 206 53 33

#### **Vizat tranzit (A, B):**

Viza aeroportuale (A) ju lejon të kaloni tranzit nëpër një aeroport ndërkombëtar në zonën e Shengenit, pa hyrë në territorin e Shengenit. Shtetasit e Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë nuk kanë nevojë për vizë aeroportuale (A).

Viza tranzit (B) lëshohet për një periudhë prej 5 ditësh për të kaluar tranzit nëpër territorin e Shengenit me rrugë tokësore.

#### **Viza Shengen për qëndrim afatshkurtër (C):**

Meqë Polonia është Shtet Anëtar i Marrëveshjes Shengen, një vizë hyrjeje në Poloni garanton të drejtën për të hyrë në të gjithë zonën Shengen. Viza për qëndrimin afatshkurtër (C) i lejon personit të qëndrojë deri në 90 ditë në territorin Shengen në një periudhë të caktuar 180-ditore për qëllime turizmi, familjare ose tregtare.

Shtetasit kroatë nuk kanë nevojë të aplikojnë për vizën e qëndrimit afatshkurtër (C). Shtetasit nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia i nënshtrohen kriterëve të vizës. Mbi bazën e Marrëveshjeve për Lehtësimin e Vizave dhe për Ripranimin ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, shtetasit e këtyre vendeve vazhdojnë të kenë nevojë për vizë Shengen C për të hyrë në Itali; megjithatë, ata përfitojnë nga një tarifë e reduktuar për lëshimin e vizës (35 Euro dhe jo 60 Euro). Shumë kategori aplikantësh (pjesëtarë familjesh të shtetasve me qëndrim të ligjshëm, studentët dhe pensionistët, gazetarët, etj.) tani mund të përfitojnë viza pa pagesë.

Për kategori të caktuara personash, psh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kriteret për dokumente janë më të thjeshtuara. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (duke përfshirë tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësues të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje që janë të vlefshme për periudha të gjata, ndërsa personat me pasaporta diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Për detaje shikoni:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)  
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnje-Hercegovinën)  
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë  
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> për Serbinë  
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> për Malin e Zi

Për të aplikuar për vizë për qëndrim afatshkurtër (C), ju duhet të dorëzoni:

1. formularin e aplikimit ([http://www.msz.gov.pl/gallery/serwis/visa\\_en\\_52.pdf](http://www.msz.gov.pl/gallery/serwis/visa_en_52.pdf))
2. 2 fotografi për pasaportë
3. pasaportën e vlefshme
4. biletën e kthimit ose rezervimin e hotelit në rast hyrjeje për qëllime turizmi
5. prova dokumentare në lidhje me qëllimin e udhëtimit (për detaje në lidhje me dokumentet specifike që nevojiten, ju lutemi të kontaktoni me ambasadën më të afërt)
6. prova të mjeteve të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit

Personat që kanë leje qëndrimi polake mund të udhëtojnë nëpër territorin Shengen pa pasur nevojë të aplikojnë për vizë Shengen.

### **Viza afatgjatë (D)**

Viza afatgjatë është e vlefshme vetëm për territorin e Polonisë dhe jo për të gjithë zonën Shengen. Ajo lëshohet për periudhën e kohës që i korrespondon arsyeve për të cilat lëshohet dhe nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vjet. Viza për qëndrim afatgjatë mund të lëshohet për:

- një vizitë
- të kryer një aktivitet ekonomik
- të kryer një aktivitet kulturor ose për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare
- të kryer funksionet ligjore të një përfaqësuesi të një shteti të huaj ose organizate ndërkombëtare
- qëllime azili
- qëllime pune
- shkollim ose trainim
- mbrojtje të përkohshme.

Për të aplikuar për vizë afatgjatë për qëllime punësimi, ju duhet të dorëzoni në ambasadën/konsullatën më të afërt polake:

- premtimin për të marrë leje pune lëshuar nga autoriteti vendor (Voivode) në vendin e ardhshëm të qëndrimit në Poloni. Ky premtim është një dokument zyrtar nëpërmjet të cilit Voivode merr përsipër të lëshojë lejen e punës (vetëm në rast se ju merrni vizën ose lejen e qëndrimit për një periudhë të caktuar kohe)
- ose një dokument që vërteton qëllimin e punëdhënësit për t'ju punësuar, në rastin e sektorëve të punësimit që nuk kërkojnë leje pune
- formularin e aplikimit për vizë
- pasaportën e vlefshme
- dy fotografi për pasaportë

Për të aplikuar për vizë afatgjatë për qëllime studimi, ju duhet të dorëzoni në ambasadën/konsullatën më të afërt polake:

- një certifikatë regjistrimi lëshuar nga universiteti, akademia, instituti, kolegji apo shkolla pritëse
- një certifikatë mjekësore

Për detaje të plota në lidhje me kriteret dhe dokumentet që nevojiten për situatën tuaj specifike ose për të aplikuar, ju lutemi të kontaktoni me ambasadën ose konsullatën më të afërt polake.

### 3. Imigracioni për qëllime punësimi

#### a) kushtet e hyrjes dhe qëndrimit për punëtorët e huaj

Për vizën afatgjatë (D) lëshuar për qëllime pune, ju lutemi t'i referoheni seksionit 2 më sipër.

#### Leja e punës

Përgjithësisht, shtetasit e huaj duhet të sigurojnë leje pune përpara se të punësohen në Poloni. Kjo dispozitë e përgjithshme zbatohet si për personat e përfshirë në një marrëdhënie tradicionale punëdhënës/punonjës, ashtu edhe për sipërmarrësit e pavarur të cilët ofrojnë shërbime mbi bazë kontrate. I njëjti rregull zbatohet edhe për transferimet brenda së njëjtës shoqëri.

Për të punuar në Poloni, ju duhet fillimisht të gjeni një punëdhënës në Poloni i cili të pranojë të aplikojë për leje pune pranë një Voivodship-i në rajonin ku është e vendosur shoqëria/institucioni. Leja e punës jepet vetëm nëse vërtetohet se nuk ka asnjë shtetas polak apo të BE-së të disponueshëm për pozicionin në fjalë (testi i tregut të punës).

Procedura për të punësuar një të huaj në pjesën më të madhe të rasteve përbëhet nga tre faza.

1) procedura fillon me aplikimin për Premtimin për të lëshuar leje pune pranë autoritetit vendor përkatës (Voivode). Ky dokument është baza për të lëshuar vizë pune dhe leje pune, të cilat do t'ju mundësojnë të hyni dhe qëndroni në Poloni për periudhën e kontratës së punësimit. Aplikimi i drejtohet punëdhënësit të ardhshëm në Zyrën vendore të Punës në vendin ku keni për qëllim të punësoheni.

Punëdhënësi i ardhshëm është i detyruar ta bëjë njoftimin për vendin e lirë nëpërmjet agjencive të punës, shtypit, Internetit dhe EURES (rrjetit Evropian të Shërbimeve të Punësimit). Punëdhënësi aplikon për leje pune pranë Voivode. Voivode shqyrton aplikimin duke marrë në konsideratë situatën e tregut vendor të punës nëpërmjet "testit të tregut të punës" dhe lëshon një premtim që i paraprin nxjerrjes së lejes së punës.

Punëdhënësit që punësojnë të huaj nuk kanë detyrimin për të aplikuar për premtimin e lejes së punës nëse në ditën e dorëzimit të aplikimit, i huaji ka një vizë pune të vlefshme ose një vizë polake për qëndrim të përhershëm.

2) Me miratimin e Premtimit të vendimit për leje pune, punëdhënësi jua dërgon premtimin dhe aplikimi për vizë pune mund të dorëzohet pranë Ambasadës/Konsullatës polake në vendin ku qëndroni në mënyrë të ligjshme. Premtimi duhet t'i bashkangjitet aplikimit për vizë.

3) Pas mbërritjes në Poloni, duhet të legalizoni qëndrimin tuaj (dmth. të siguron një leje qëndrimi të përkohshme). Pasi merrni lejen e mësipërme, punëdhënësi paraqet tek voivode datën e mundshme kur ju do të filloni punë dhe voivode lëshon lejen e punës (për një periudhë jo më të gjatë se viza e punës apo leja e qëndrimit).

Kategoritë e personave që nuk kanë nevojë për leje pune:

- personat që kanë leje vendosjeje lëshuar para datës 1 maj 2004
- personat që kanë leje qëndrimi të përhershme lëshuar pas datës 1 maj 2004
- shtetasit e Shteteve Anëtare të ZEE (Zonës Ekonomike Evropiane) dhe pjesëtarëve të familjes, edhe pse ata nuk janë shtetas të ZEE-së
- personat që kanë një leje qëndrimi afatgjatë të KE-së
- pjesëtarët e familjes së një shtetasi polak
- refugjatët dhe personat me qëndrim të toleruar; mbrojtje të përkohshme ose plotësuese
- të huajt që zhvillojnë trainime, marrin pjesë në kurse trainimi, kryejnë funksione këshilluese/mbikëqyrëse ose funksione që kërkojnë kualifikime dhe aftësi të veçanta në programe që realizohen brenda kuadrit të veprimtarive të Bashkimit Evropian ose programeve të tjera të ndihmës ndërkombëtare
- të huajt, të cilët në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare që ka nënshkruar Polonia, lejohen që të kryejnë punë pa pasur leje pune
- mësuesit e gjuhëve të huaja nëse nevoja për punësimin e tyre është konfirmuar nga ministri përkatës i arsimit dhe trainimeve ose nëse gjuha që ata japin është gjuha e tyre amtare
- të huajt që janë mësues të gjuhëve të huaja nëse janë shtetas të ZEE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë ose Zelandës së Re, nëse gjuha që ata japin është gjuha e tyre amtare;
- personeli që kryen punë në strukturat ushtarake ndërkombëtare me bazë në Poloni

- korrespondentët e huaj të përhershëm të mjeteve të komunikimit masiv, të akredituar nga ministri përkatës i punëve të jashtme
- artistët (deri në 30 ditë brenda një viti kalendarik) si aktorët, muzikantët, valltarët ose imituesit;
- të huajt që duke ruajtur lejen e qëndrimit të përhershëm në vendet e tjera, japin herë pas here leksione, fjalime apo prezantime me vlerë të veçantë shkencore ose artistike, deri në 30 ditë brenda një viti kalendarik
- sportistët që punojnë për një institucion që ka zyrat qendrore në Poloni, nëse kjo punë ka natyrë sporadike;
- përfaqësuesit fetarë
- studentët e kurseve të ditës në Poloni për punë gjatë muajve të korrikut, gushtit dhe shtatorit;
- studentët që punojnë në kuadrin e një trainimi, të dërguar nga organizata që janë anëtare të sindikatave ndërkombëtare të studentëve;
- të huajt e caktuar me punë në institucione kulturore të shteteve të huaja në territorin e Republikës së Polonisë
- të huajt që, duke ruajtur lejen e qëndrimit të përhershëm në vende të tjera, delegohen në territorin e Republikës së Polonisë nga një punëdhënës i huaj për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj brenda një viti kalendarik, për qëllime të:
  - a) kryerjes së punëve për montimin, mirëmbajtjen ose riparimin e pajisjeve që prodhohen nga një punëdhënës i huaj;
  - b) marrjen e aparaturave, makinerive ose pajisjeve të tjera të porositura, që kryhet nga një tregtar polak;
  - c) trainimin e punonjësve të një punëdhënësi polak që është marrësi i aparaturave, strukturave, makinerive ose pajisjeve të tjera të përmendura në pikën a), gjatë periudhës së mirëmbajtjes apo përdorimit;
  - d) montimit ose çmontimit të pajisjeve të ekspozimit, si dhe ruajtjes së tyre, nëse ekspozuesi është punëdhënës i huaj që këtë punë ua delegon të huajve;
- shtetasit e vendeve jo-anëtare të BE-së që janë punësuar në territorin e një shteti anëtar të BE-së, të cilët ky punëdhënës i delegon përkohësisht në Poloni për të ofruar shërbime;
- shtetasit turq, pas një periudhe katër-vjeçare pune të ligjshme në Poloni dhe pjesëtarët e familjeve të tyre nëse jetojnë në një banesë të përbashkët në Poloni për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh;
- shtetasit turq, të cilët janë diplomuar në shkolla ose universitete polake dhe janë fëmijë të shtetasve turq që kanë punuar në mënyrë të ligjshme në Republikën e Polonisë për të paktën tre vjet;
- personat që kryejnë punë për ambasadorët e Bashkimit Evropian lidhur me funksionin e tyre;
- përfaqësuesit akademikë të fushave që parashikohen në rregulloret për organizmat e kërkim-zhvillimit;
- mjekët ose kirurgët dentarë që janë diplomuar në universitetet mjekësore polake,
- infermieret ose mamitë, të cilat janë diplomuar nga kolegjet e infermierisë polake,
- shtetasit e vendeve fqinje me Republikën Polake (Bjellorusisë, Ukrainës dhe Rusisë) deri në gjashtë muaj gjatë një periudhe prej 12 muajsh të pandërprerë.
- Personat që kanë marrë të ashtuquajturën "Kartën Polake" për persona me origjinë polake, por që kanë humbur shtetësinë polake si pasojë e ndryshimit të kufijve pas Luftës së Dytë Botërore dhe janë shtetas të KVP (Komonuelthit të Vendeve të Pavarura).

## **b) sektorët e tregut të punës që po përjetojnë mungesa**

Pas shumë vitesh të teprisë së ofertave në tregun e punës dhe papunësisë së lartë, Polonia tani po përjeton mangësi në ofertën për punë. Në vitin 2006, pjesa më e madhe e vendeve të punës u krijua në prodhim, tregti dhe riparime, pronat e patundshme dhe ndërtim. Numri më i madh i vendeve të lira të punës tani është i disponueshëm për njerëz me arsim bazë profesional dhe së dyti, për njerëz me arsim të lartë. Specializimet më të kërkuara përfshijnë: profesionistët (financë, sigurime, marketing, logjistikë dhe specialistë të teknologjisë së informacionit), teknikë dhe artizanë të kualifikuar ose të pakualifikuar.

## **c) faqe elektronike për të kërkuar punë**

[www.monsterpolska.pl](http://www.monsterpolska.pl)

[www.jobs.pl](http://www.jobs.pl)

[www.epraca.com.pl](http://www.epraca.com.pl)

[www.pracuj.pl](http://www.pracuj.pl)

[www.praca.pl](http://www.praca.pl)

<http://www.ogloszeniapraca.eua.pl/>

<http://www.i-praca.pl/>

<http://www.gowork.pl/>

<http://www.eures.praca.gov.pl/>

## d) au-pair<sup>1</sup> dhe programet e huaja specifike për punë

Shtetasit e vendeve fqinje me Republikën e Polonisë (Bjellorusisë, Ukrainës dhe Rusisë) mund të punojnë në Poloni pa leje pune deri në gjashtë muaj gjatë një periudhe prej 12 muajsh të pandërprerë.

## 4. Imigracioni për arsye studimi

### a) Sistemi i arsimit të lartë polak

Institucionet e arsimit të lartë (IAL) në Poloni ofrojnë kategoritë e mëposhtme të kurseve të studimit:

- Studime të larta profesionale (3-4 vjet): të diplomuarit përfitojnë një diplomë profesionale licensjat ose të inxhinierisë; (BA)
- Studime master (5-6 vjet); i diplomuari përfiton, në varësi të profilit të kursit, një diplomë profesionale master [magister] ose një diplomë të barasvlershme; (MA)
- Studime pasuniversitare master (2-2.5 vjet) për të diplomuar të studimeve të larta profesionale; i diplomuari përfton një diplomë master profesionale ose një diplomë të barasvlershme; (PhD)
- Studime doktrature (3-4 vjet): kandidatët që plotësojnë kriteret janë të diplomuar të studimeve të larta me një diplomë master profesionale, që punojnë për titullin akademik doktor;
- Studime pasuniversitare (1-2 vjet) – për të diplomuar të të gjitha lloje të IAL.

Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë kurse me kohë të plotë, kurse jashtëshkollore, kurse mbrëmjeje dhe kurse të jashtme. Kurset me kohë të plotë përbëjnë sistemin bazë të studimeve.

Ka dy tipe institucioneve të arsimit të lartë:

- IAL të tipit universitar që ofrojnë studime në shkencat sociale, shkencat e sakta, mjekësi, ekonomi, pedagogji, arte dhe studime ushtarake;
- IAL profesionale, të cilat i arsimojnë studentët në fusha specifike profesionale dhe i përgatisin për të ushtruar një profesion.

### Diplomat Profesionale që u jepen të diplomuarve të IAL në Poloni

Në Poloni, të diplomuarit e institucioneve të arsimit të lartë marrin diplomat e mëposhtme:

- **licensjat** [licencjat] – diplomë që përfitohet në përfundim të kursit profesional të arsimit të lartë që zgjat 3-3.5 vjet;
- **inxhinier** [inżynier] – diplomë që përfitohet në përfundim të kursit profesional të arsimit të lartë në fushën e inxhinierisë, bujqësisë apo ekonomisë, që zgjat 3.5 – 4 vjet;
- **master** [magister] dhe diploma të barasvlershme: master në arte, master në inxhinieri, master në inxhinieri–arkitekt, mjek, dentist, veteriner – që përfitohet në përfundim të 5-6 viteve studime të vazhdueshme master. Një mënyrë tjetër për të përfituar një diplomë master është të përfundosh një kurs masteri pasuniversitar prej 2-2.5 vjetësh për personat që kanë diplomë të arsimit të lartë profesional.

Për të siguruar këto diploma profesionale, studenti duhet të kalojë vlerësimin për secilën prej lëndëve dhe detyrat praktike të tij/saj, të paraqitet dhe të mbrojë disertacionin e diplomës, si dhe të kalojë provimin e diplomës.

Të diplomuarit të cilët ndjekin kurset e doktoraturës ose kryejnë punë kërkimore mund të punojnë për të marrë diplomat e mëposhtme akademike:

- **doktor** [doktor]: diplomë që i jepet personit i cili kalon provimet e doktoraturës dhe paraqet dhe mbron me sukses një disertacion doktrature [project]. Ata që dëshirojnë të punojnë për diplomën akademike të doktorit duhet të kenë një diplomë profesionale master ose një diplomë të barasvlershme;
- **doktor i kualifikuar** [doktor habilitowany]: kjo diplomë i jepet kandidatëve që kanë një diplomë doktrature, kanë kryer arritje të rëndësishme akademike ose artistike, kanë paraqitur një disertacion të kualifikuar dhe kanë përfunduar me sukses procedurën e kualifikimit.

**Profesor** [profesor] është një titull akademik që jepet nga Presidenti i Republikës së Polonisë.

### Stuktura e Kurseve të Studimit dhe Viti Akademik

Viti akademik përbëhet nga 30 javë studimi, me rreth 30 orë mësimi për javë dhe ndahet në dy semestre:

- semestri i dimrit (nga 1 tetori deri rreth 15 shkurtit të vitit të ardhshëm kalendarik) që përfshin 15 javë studimi dhe periudhën e provimeve të dimrit;

---

<sup>1</sup> Shënim i përkthyesit: I/e re me shtetësi të huaj, i/e cili/a kryen punë shtëpie në këmbim të strehimit dhe ushqimit, kryesisht për të mësuar gjuhën.

- semestrin e verës (nga rreth 16 shkurti deri në 30 shtatori) që përfshin 15 jave studimi dhe periudhën e provimeve të verës;

### **Provimet**

Studentët kanë nga një provim për çdo lëndë. Periudha e vlerësimit përfshin ose një semestër, ose një vit akademik. Për të përfunduar me sukses një semestër (ose një vit), studenti duhet të marrë një rezultat kalues (dmth të paktën "kënaqshëm") për të gjitha vlerësimet dhe provimet në lëndët që përfshin programi i tij/saj mësimor dhe të përfitojë kredite vlerësimi për të gjitha lëndët e integruara të programit.

Çdo IAL e përcakton shkallën e vlerësimit në Rregulloret e Studimit. Shkalla më e zakonshme përfshin notat e mëposhtme:

- shumë mirë (5)
- mirë plus (4+ ose 4.5)
- mirë (4)
- kënaqshëm plus (3+ ose 3.5)
- kënaqshëm (3)
- jo-kaluese (2).

Përveç kësaj shkalle vlerësimi, IAL polake kanë filluar të përdorin Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (SETK) sipas të cilit çdo lëndë i caktohet një numër kreditesh, pavarësisht nga vlerësimi i marrë. Në varësi të lëndës, një rezultat kalues i siguron studentit nga 2 deri në 12-14 kredite SETK. Me të marrë një provim, studenti duhet të kërkojë që kjo të vendoset në dosjen e tij bashkë me kreditet e siguruar. Për të kaluar me sukses një vit ose semestër, studenti duhet të mbledhë përkatësisht 30 ose 60 kredite. Me sistemin SETK tashmë një numër gjithmonë e më i madh i studentëve polakë mund t'i kryejnë studimet e tyre ose pjesë të tyre në një institucion të huaj të arsimit të lartë. Gjithashtu, kreditet SETK mundësojnë që studentëve të huaj t'u njihen periudhat e studimit në IAL polake.

### **Projektet e Diplomës dhe Provimet e Diplomës**

Për të përfituar një diplomë të arsimit të lartë, një student duhet:

- të kalojë vlerësimin për të gjitha lëndët, lëndët e integruara dhe sesionet e punës praktike, si dhe të kalojë të gjitha provimet që përfshin programi i studimit i përcaktuar për fushën përkatëse;
- të paraqesë, në një datë të caktuar, një projekt diplome dhe të marrë një notë kaluese për të;
- të kalojë provimin e diplomës.

### **Kostoja**

Arsimi me kohë të plotë në institucionet shtetërore të arsimit të lartë është falas për shtetasit polakë.

Nëse ju:

- keni një leje vendosjeje;
- jeni një refugjat i njohur nga Polonia;
- keni mbrojtje të përkohshme në Poloni;
- jeni shtetas i një Vendi Anëtar të BE-së ose një vendi anëtar i Traktit të Zonës Ekonomike Evropiane, ish-i punësuar ose i punësuar aktualisht në Poloni; ose një pjesëtar familjeje i personave të mësipërm, që banon në Poloni;

jeni i lirë të filloni dhe ndiqni studimet dhe të merrni pjesë në kërkimet shkencore, projektet dhe skemat e trainimit njëlloj si shtetasit polakë, dmth të keni mundësinë për mësim falas, të aplikoni për bursa, grante shkollimi, kredi studentore, strehim studentit, etj.

Të gjithë studentët e tjerë të huaj duhet të paguajë tarifat e shkollimit në shumën jo më pak se sa i korrespondon në zlotë polakë (PLN) shifrës prej:

- 2000 Euro në vit për studimet e larta profesionale, kurset master dhe master pasuniversitare;
- 3000 Euro në vit për kurset e mjekësisë, pasuniversitare dhe të specializuara, si dhe stazhin e degëve të shkencave, artit, të specializuara dhe të kualifikuara;
- 3000 Euro në vit për kurset profesionale;
- 2000 Euro në vit për kurs gjuhe, duke përfshirë një kurs përgatitjeje për studime në gjuhën polake.

Në raste të argumentuara, IAL, me kërkesën e studentit, mund të reduktojë tarifën e shkollimit ose ta heqë atë plotësisht.

Kostoja e strehimit në Ambientet e Studenteve varion nga 140 deri në 200 Euro në muaj për një dhomë teke dhe nga 50 deri në 80 Euro për një dhomë të përbashkët, në varësi të standardit.

Shiko gjithashtu tek <http://www.buwiwm.edu.pl/publ/guide/index.htm>

## **b) kushtet e hyrjes dhe qëndrimit për studentët**

Ju mund të studioni në Poloni nëse keni një vizë afatgjatë ose një leje qëndrimi të përkohshme dhe nëse jeni në gjendje të mirë shëndetësore, vërtetuar nga një certifikatë mjekësore. Ju duhet të keni një certifikatë regjistrimi ose një dokument tjetër të barasvlershëm që vërteton të drejtën për t'u shqyrtuar për pranimit në një institucion të arsimit të lartë në vendin në të cilin keni përfunduar shkollën e mesme. Çdo institucion i arsimit të lartë përcakton kushtet e regjistrimit, procedurat dhe objektin e provimit të pranimit që duhet të jepet nga kandidati vitin e ardhshëm kalendarik.

Për të aplikuar për vizë afatgjatë për qëllim studimi, ju duhet të paraqisni në ambasadën/konsullatën më të afërt polake (ndër të tjera):

- Një certifikatë regjistrimi nga universiteti, akademja, instituti, kolegji apo shkolla pritëse
- Një certifikatë mjekësore

## **E drejta për punë**

Studentët e kurseve të nivelit të tretë me kohë të plotë në Poloni nuk kanë nevojë për leje pune për t'u punësuar gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator.

## **b) bursa universitare dhe pasuniversitare**

Ministria e Shkencës dhe Arsimit të Lartë herë pas here përcakton një kuotë bursash për personat që ndjekin arsimin në Poloni sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ose sipas vendimit të Ministrit të Arsimit të Lartë. Aplikimet e studentëve të huaj për bursa të kësaj kuote transmetohen nga misionet konsullore/diplomatike polake tek Byroja për Njohjen Akademike dhe Shkëmbimet Ndërkombëtare. Që këtu, aplikimet shqyrtohen nga Seksioni i Byrosë për Rekrutimin dhe Shkollimin e të Huajve në Poloni. Vendimi përfundimtar merret nga Ministri i Shkencës dhe Arsimit të Lartë.

## **Bursat sipas marrëveshjeve ndërmjet shkollave**

Disa institucione të arsimit të lartë polake dhe të huaja kanë marrëveshje për shkëmbimin e përkohshëm të studentëve dhe stafit akademik dhe kërkimor. Në çdo rast, IAL-të e përfshira vendosin bashkërisht për rregullat për dhënien e bursave. Një student i huaj që kërkon bursë në Poloni duhet të plotësojë disa kritere specifike të shkëmbimit ndërmjet shkollave.

Disa IAL kanë programet e tyre të bursave.

## **c) listë e universiteteve dhe kolegjeve kryesore**

shiko tek <http://www.unesco.org/iau/onlinedatabases/list.html>

## **d) programet për studentët e huaj sipas fushave**

Programet akademike ndërkombëtare

[http://www.academicintl.com/country.php?country\\_id=7&content\\_id=7&country\\_image\\_id=7](http://www.academicintl.com/country.php?country_id=7&content_id=7&country_image_id=7)

Shkollimi Antioch Jashtë

<http://aea.antioch.edu/eit/> <http://aea.antioch.edu/ws/>

MA për Studimet Transatlantike në Krakow

<http://www.transatlantic.uj.edu.pl/main.php>

Studime Evropiane në Krakow

<http://www.ces.uj.edu.pl/>

Programe Master në Drejtësi (LLM) në Poloni

<http://www.llm-guide.com/poland>

Informacion të mëtejshëm mund të gjeni tek: <http://www.howtostudyinpoland.pl/index.php>

## 5. Qëndrimi

### Leja e qëndrimit të përkohshëm (pobyt na czas oznaczony)

Leja e qëndrimit të përkohshëm mund të jepet për një periudhë deri në 2 vjet, me mundësinë e një zgjatjeje, e cila nuk mund t'i kalojë 10 vjetët.

Leja e qëndrimit të përkohshëm i lëshohet një migranti i cili:

- Ka siguruar një premtim për të lëshuar lejen e punës nga Voivode përkatëse ose një deklaratë me shkrim nga punëdhënësi që vërteton qëllimin për të punësuar migrantin, nëse nuk nevojitet leja e punës. Leja e punës lëshohet nga Voivode me kërkesën e një punëdhënësi i cili synon ta punësojë migrantin. Migranti duhet të vërtetojë një burim të qëndrueshëm e të rregullt të ardhurash që mjafton për të mbuluar shpenzimet e tij/saj si dhe shpenzimet e pjesëtarëve të familjes, sigurimin shëndetësor dhe titullin e ligjshëm të banesës në të cilin migranti qëndron apo synon të qëndrojë.
- Kryen një aktivitet ekonomik i cili është i dobishëm për ekonominë e kombit dhe në veçanti, kontribon për zhvillimin e investimeve, transferimin e teknologjisë, risitë dhe krijimin e vendeve të punës. Një migrant duhet të demonstrojë një burim të qëndrueshëm dhe të rregullt të ardhurash i cili mjafton për të mbuluar shpenzimet e tij/saj si dhe shpenzimet e pjesëtarëve të familjes, sigurimin shëndetësor dhe titullin e ligjshëm të banesës në të cilin migranti qëndron apo synon të qëndrojë.
- Është një person me arritje të njohura në fushën e artit, i cili synon të vazhdojë veprimtarinë krijuese në Poloni,
- Merr pjesë në trainime dhe trainime profesionale që kryhen në bazë të programeve të Bashkimit Evropian,
- Synon që, si pjesëtar familjeje, të shoqërojë një punëtor migrant të referuar në Kartën Sociale Evropiane, lidhur në Turin më 18 tetor 1961,
- Është bashkëshort/e e një shtetasi/e polak/e
- Për qëllimet e bashkimit familjar me një pjesëtar familjeje që jeton në Poloni
- Është një i mitur i pashoqëruar që ka lindur në Poloni
- Është bashkëshorti ose fëmija i rritur i një migranti që qëndron në Poloni, i cili qëndron në Poloni për të paktën 5 vjet mbi bazën e lejes së qëndrimit të përkohshëm lëshuar për qëllime të bashkimit familjar
- Është një migrant i ve, i divorcuar ose i ndarë, ose prindi apo fëmija i të cilit ka vdekur dhe ai/ajo qëndron në Poloni mbi bazën e lejes së qëndrimit të përkohshëm që është lëshuar për qëllime të bashkimit familjar, nëse kjo është në interesin e migrantit. Interesi i migrantit, i cili justifikon dhënien e lejes së qëndrimit, mund të jetë që fëmija e tij/saj të ndjekë shkollën, të integrohet në shoqëri ose ta përqëndrojë veprimtarinë jetësore në Poloni,
- Është një migrant i ve ose i divorcuar që qëndron në Poloni, i cili ka qenë bashkëshort i një shtetasi polak nëse leja e qëndrimit të përkohshëm lëshohet për shkak të interesit të migrantit,
- Është një fëmijë i mitur, i lindur në Poloni nga një migrant që ka një leje qëndrimi të përkohshëm
- Ka marrë lejen e qëndrimit afatgjatë të KE-së në një vend tjetër të BE-së dhe synon të punojë, kryejë një aktivitet ekonomik, studiojë ose marrë pjesë në trainime në Poloni ose vërteton arsye të tjera për qëndrimin në Poloni. Leja e qëndrimit të përkohshëm mund t'i lëshohet bashkëshortit të këtij migranti. Migranti duhet të vërtetojë një burim të qëndrueshëm e të rregullt të ardhurash që mjafton për të mbuluar shpenzimet e tij/saj si dhe shpenzimet e pjesëtarëve të familjes, sigurimin shëndetësor dhe titullin e ligjshëm të apartamentit në të cilin migranti qëndron apo synon të qëndrojë.
- Është një viktimë e trafikimit, e cila qëndron në territorin e Polonisë, bashkëpunon me Policinë dhe ka shkëputur kontaktet me trafikantët (leja jepet deri në 6 muaj),
- Voivode mund të japë leje qëndrimi të përkohshëm me kusht që migranti të plotësojë kriteret e specifikuar nga Voivode. Leja e qëndrimit të përkohshëm mund t'i jepet migrantit që:
- Synon të fillojë apo vazhdojë studimet, ose marrë pjesë në trainime profesionale në Poloni. Migranti duhet të tregojë certifikatën e pranimit për studime, lëshuar nga institucioni përkatës për studimet e tij/saj (leja jepet deri në 1 vit)
- Vërteton se në sajë të rrethanave të tjera, përveç çështjes së detyrueshme të lejes së qëndrimit të përkohshëm, qëndrimi i tij/saj në Poloni është i justifikuar brenda një periudhe më të gjatë se 3 muaj. Këto rrethana mund të jenë kujdesi për një pjesëtar familjeje të sëmurë të migrantit. Në një situatë të tillë, Voivode mund ta lëshojë lejen e qëndrimit të përkohshëm. Migranti duhet të vërtetojë një burim të qëndrueshëm e të rregullt të ardhurash që mjafton për të mbuluar shpenzimet e tij/saj si dhe shpenzimet e pjesëtarëve të familjes, si dhe sigurimin shëndetësor. Migranti nuk ka detyrimin për të paraqitur titullin e ligjshëm për banesën në të cilin qëndron apo synon të qëndrojë.

Aplikimi duhet të dorëzohet tek Voivode përkatëse që ka juridiksion mbi vendin ku migranti synon të qëndrojë në Poloni. Migranti që jeton jashtë duhet të paraqesë aplikimin nëpërmjet konsullit. Vendimi lëshohet nga Voivode përkatëse që ka juridiksion mbi vendin ku migranti synon të qëndrojë në Poloni.

Aplikimi për qëndrim duhet të jetë në gjuhën polake. Dokumentet mbështetëse që mund të jenë në gjuhë të tjera duhet të përkthehen nga një përkthyes zyrtar. Voivode ose konsulli mund t'i kërkojnë aplikantit të tregojë dokumentin origjinal për të konfirmuar kopjen.

Aplikanti duhet të paraqesë të gjitha dokumentet e nevojshme për të vërtetuar të dhënat e përfshira në aplikim dhe rrethanat që justifikojnë aplikimin (psh. lejen e punës, certifikatën e martesës ose certifikatën nga universiteti). Një migrant që aplikon për leje qëndrimi të përkohshëm, i cili:

- Ka siguruar një premtim për të lëshuar lejen e punës ose zgjatjen e këtij premtimi, ose deklaratën me shkrim të punëdhënësit që vërteton qëllimin për ta punësuar migrantin, në rast se nuk nevojitet leja e punës,
- Kryen një aktivitet ekonomik,
- Synon të mbërrijë në Poloni për qëllime të bashkimit familjar,
- Qëndron në territorin e Polonisë mbi bazën e lejes së qëndrimit të përkohshëm e cila i është dhënë për qëllime të bashkimit familjar,
- I është lëshuar leja e qëndrimit afatgjatë të KE-së në një vend tjetër të BE-së, i cili synon të punojë ose kryejë aktivitet ekonomik në Poloni ose është bashkëshorti i këtij migranti,
- Studion

përveç dokumenteve përkatëse, duhet gjithashtu të ketë:

- Të siguruar strehimin në Poloni, dmth titullin e ligjshëm të një banese në të cilin migranti qëndron ose synon të qëndrojë dhe konfirmon koston e marrjes me qira të një apartamenti. Migranti duhet t'i bashkangjisë aplikimit, një kontratë qiraje që përcakton tarifën e qirasë. Mjafton edhe titulli i ligjshëm i banesës së njërit prej gjyshërve, fëmijëve, bashkëshortit, prindërve të bashkëshortit ose të afërmit të migrantit
- Vërtetim për një burim të qëndrueshëm e të rregullt të ardhurash që mjafton për të mbuluar shpenzimet e tij/saj si dhe shpenzimet e pjesëtarëve të familjes,
- Sigurimin shëndetësor.

Aplikimi për dhënien e lejes së qëndrimit të përkohshëm duhet të dorëzohet të paktën 45 ditë para përfundimit të vlefshmërisë së vizës ose periudhës së vlefshmërisë së lejes së mëparshme të qëndrimit të përkohshëm.

Nëse nuk është e mundur dhënia e vendimit brenda kësaj periudhe kohore, Voivode do t'i lëshojë migrantit një vizë të re ex officio. Viza e re nuk mund të skadojë përpara përfundimit të procedurave të shkallës së parë.

Migranti, të cilit nuk është i dhënë leja e qëndrimit të përkohshëm mund të bëjë ankim ndaj vendimit pranë Presidentit të Zyrës për të Huajt. Në një rast të tillë, migranti nuk ka detyrimin për t'u larguar nga territori i Polonisë përpara përfundimit të periudhës së qëndrimit siç tregohet në vizë, derisa të merret vendimi për ankimin.

### **Leja e qëndrimit afatgjatë të KE-së**

Leja e qëndrimit afatgjatë të KE-së mund t'i lëshohet një migranti që qëndron në Poloni në mënyrë të ligjshme dhe të pandërprerë për të paktën 5 vjet, i cili ka një titull të ligjshëm për banesën në të cilën qëndron apo synon të qëndrojë, një burim të qëndrueshëm e të rregullt të ardhurash që mjafton për të mbuluar shpenzimet e tij/saj si dhe shpenzimet e pjesëtarëve të familjes, si dhe sigurimin shëndetësor. Leja e qëndrimit afatgjatë të KE-së lëshohet për një periudhë të pakufizuar kohe.

Periudhat e mëposhtme të qëndrimit të migrantit nuk do të përfshihen në pesë vjetët e qëndrimit nëse ai/ajo:

- Është ndaluar, arrestuar për qëllime të dëbimit ose të cilit i është kufizuar liria mbi bazën e një vendimi të gjykatës,
- Punon si "au pair", është punëtor sezonal ose ofron shërbime ndërkufitare,
- Qëndron në Poloni mbi bazën e një vize të veçantë lëshuar nga Voivode pasi ka marrë miratimin e Presidentit të Zyrës për të Huajt,
- Qëndron në Poloni mbi bazën e lejes së qëndrimit për një periudhë të caktuar kohe, dhënë për qëllime të bashkimit familjar,
- Është shef ose pjesëtar i personelit të një misioni diplomatik.

## Leja për t'u vendosur

Leja për t'u vendosur mund t'i lëshohet një migranti, i cili ka të paktën dy vjet qëndrimi të përkohshëm të vazhdueshëm në Poloni, mund të vërtetojë ekzistencën e lidhjeve të përhershme familjare ose ekonomike me Poloninë dhe e ka strehimin dhe mbështetjen të siguar në Poloni.

Personat e mëposhtëm mund të aplikojnë për lejen për t'u vendosur:

- Fëmijë të mitur të personave me leje për t'u vendosur, nëse kanë lindur në Poloni
- Fëmijë të mitur të shtetasve polakë dhe nën kujdesin e tyre
- Bashkëshortët e shtetasve polakë, me kusht që martesë të jetë kryer të paktën tre vjet përpara aplikimit dhe bashkëshorti të ketë qenë me qëndrim të përkohshëm në Poloni për të paktën dy vjet
- Refugjatët pas pesë vjetësh qëndrimi të vazhdueshëm dhe personat me qëndrim të toleruar pas 10 vjetësh qëndrimi të vazhdueshëm

Menjëherë sapo t'ju miratohet leja e qëndrimit, do t'ju lëshohet një kartë qëndrimi, e cila vërteton identitetin tuaj dhe bashkë me dokumentin e udhëtimit ju lejon të kaloni kufirin disa herë pa pasur nevojë për vizë.

## 6. Procedura e azilit

Organi përgjegjës për miratimin e statusit të refugjatit në Poloni është **Zyra për të Huajt**. <http://www.udsc.gov.pl/>

Një aplikant duhet të paraqesë aplikimin për marrjen e statusit të refugjatit nëpërmjet oficerit drejtues të divizionit të **Rojes Kufitare**, objekti territorial i veprimtarisë së të cilëve përfshin qytetin e Varshavës ose nëpërmjet oficerit komandues të pikës së kontrollit të Rojes Kufitare, gjatë kontrollit kufitar në hyrjen në Poloni.

Ndihma për azilkërkuesit përfshin strehimin në qendër ose përfitimin financiar për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit në Poloni, si dhe shpenzimet e kujdesit mjekësor. Ndihma mund të përfshijë gjithashtu shpenzimet e riatdhestimit vullnetar nga Polonia.

Vendimet e Presidentit të Zyrës për të Huajt për dhënien dhe heqjen e statusit të refugjatit mund të apelojnë pranë Bordit të Refugjatëve.

Nëse aplikantit i refuzohet statusi i refugjatit, atij/asaj mund t'i jepet leja për qëndrim të toleruar ose të urdhërohet të largohet nga territori i Republikës së Polonisë brenda afatit kohor të përcaktuar në vendim, që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë.

Leja për qëndrim të toleruar i jep personit të drejtën për të punuar në Poloni pa leje pune, kujdes mjekësor falas dhe forma të tjera të mbështetjes shoqërore.

Për më shumë informacion, shikoni:

[http://www.udsc.gov.pl/Procedure\\_for\\_granting\\_the\\_refugee\\_status\\_266.html](http://www.udsc.gov.pl/Procedure_for_granting_the_refugee_status_266.html) (në gjuhën angleze)

## 7. Bashkimi familjar

Një pjesëtar familjeje i një migranti që jeton në Poloni mund të përfitojë një leje qëndrimi të përkohshëm. Personat e mëposhtëm konsiderohen pjesëtarë të familjes për qëllime të bashkimit familjar:

- një bashkëshort, nëse martesë njihet sipas ligjit polak në fuqi
- një fëmijë i mitur,
- një fëmijë i mitur i bashkëshortit të migrantit,
- prindërit e një fëmije të mitur që ka marrë status refugjati në Poloni

Leja e qëndrimit të përkohshëm për qëllime të bashkimit familjar mund t'u jepet pjesëtarëve të familjeve të:

- migrantëve me leje vendosjeje
- migrantëve me leje qëndrimi afatgjatë të KE-së
- refugjatëve të pranuar
- migrantëve që kanë pasur leje qëndrimi të përkohshëm për të paktën dy vjet

Migranti duhet të konfirmojë një burim të qëndrueshëm dhe të rregullt të ardhurash që mjafton për të mbuluar shpenzimet e tij/saj si dhe shpenzimet e pjesëtarëve të familjes, si dhe sigurimin shëndetësor, nëse aplikimi për leje qëndrimi është dorëzuar brenda tre muajve nga data e dhënies së statusit të refugjatit.

Aplikimi duhet të shoqërohet nga një titull i ligjshëm për banesën në të cilin migranti banon apo synon të banojë dhe një kontratë qiraje që përcakton shumën e qirasë.

Një pjesëtar i familjes do të marrë një leje qëndrimi për një periudhë kohe të njëjtë me periudhën për të cilën është e vlefshme leja e qëndrimit të pjesëtarit të familjes me të cilin ai synon të qëndrojë, dmth nëse një migrant që qëndron në Poloni ka një leje qëndrimi për një periudhë kohe të caktuar prej 7 muajsh, pjesëtarët e familjes së tij/saj që mbërrinë në Poloni do të marrin gjithashtu një leje qëndrimi prej 7 muajsh.

Nëse migranti që qëndron në territorin e Polonisë ka marrë lejen për t'u vendosur, lejen e qëndrimit afatgjatë të KE-së ose statusin e refugjatit, pjesëtarët e familjes së tyre do të marrin leje qëndrimi për një periudhë dy-vjeçare.

Aplikimet për bashkime familjare duhet të dorëzohen pranë autoritetit vendor përkatës (Voivode).

## **8. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor**

Nëse dëshironi të përdorni kujdesin shëndetësor, ju nuk do të duhet të paguani për vizitë apo trajtim mjekësor vetëm nëse jeni i siguruar dhe paguani sigurim shtesë. Në situata të tjera, ju do të duhet të paguani për vizitë ose trajtim mjekësor. Përjashtimet janë:

- personat nën moshën 18 vjeç,
- gratë shtatzëna, në rast lindjeje të fëmijës dhe gjatë kujdesit paslindjes

të cilët kanë të drejtë për trajtim falas shëndetësor, edhe nëse janë të pasiguruar dhe pavarësisht nga shtetësia. Për më tepër, në rast urgjence ose nëse një person është në një situatë ku i rrezikohet jeta, personat e pasiguruar kanë gjithashtu të drejtën e shërbimeve mjekësore dhe mbështetjes së shërbimeve të kujdesit publik pa pagesë.

Personat që kanë të drejtë të aplikojnë për asistencë sociale, po ashtu si personat e papunë, kanë gjithashtu të drejtë për shërbime mjekësore falas.

Nëse jeni i punësuar në Poloni, pagesa e sigurimeve shëndetësore kryhet nga punëdhënësi. Vetëm personat që kanë të drejtë për pagesën e papunësisë, mund të kenë sigurim shëndetësor falas.

Personat që kanë të drejtë të nënshkruajnë në zyrën e punës si të papunë përfshijnë:

- refugjatët dhe personat me mbrojtje të përkohshme ose plotësuese, ose me leje për qëndrim të toleruar,
- personat me leje vendosjeje,
- personat me leje qëndrimi afatgjatë të Komunitetit Evropian,
- personat me leje qëndrimi të përkohshme për arsye pune apo studimi në Poloni; bashkimi familjar dhe pjesëtarë të familjes së shtetasve polakë

Sigurimi shëndetësor mbulon gjithashtu pjesëtarët e familjes së migrantit që qëndron në Poloni dhe ka të drejtën e sigurimit shëndetësor.

## **9. Sistemi i sigurimit shoqëror**

Pagesa e papunësisë:

Kategoritë e mëposhtme të migrantëve kanë të drejtën të aplikojnë për pagesën e papunësisë:

- refugjatët dhe personat me qëndrim të toleruar; me statusin e mbrojtjes së përkohshme ose mbrojtjes plotësuese
- personat me leje vendosjeje
- personat me qëndrim afatgjatë të KE-së
- personat me leje qëndrimi të përkohshme për arsye të bashkimit familjar
- pjesëtarët e familjes së shtetasve polakë

Për të marrë pagesën e papunësisë, ju duhet të regjistroheni në Zyrën vendore të Punës. Statusi i të papunit ju jep mundësinë për të siguruar kujdes mjekësor falas.

#### Pagesa për paaftësinë/moshën (të përhershme ose të përkohshme)

Pagesa për paaftësinë/moshën u jepet personave të cilët si rezultat i paaftësisë ose moshës nuk janë në gjendje të punojnë dhe që kanë të ardhura nën një nivel të caktuar.

Kategoritë e mëposhtme të migrantëve kanë të drejtën për të aplikuar për pagesën e paaftësisë/moshës:

- refugjatët dhe personat me qëndrim të toleruar; me statusin e mbrojtjes së përkohshme ose mbrojtjes plotësuese
- personat me leje vendosjeje
- personat me qëndrim afatgjatë të KE-së

Migrantët e tjerë nuk kanë të drejtë për të siguruar mbështetjen e sigurimeve shoqërore.

#### Pagesa familjare

Kategoritë e mëposhtme të migrantëve kanë të drejtën për të aplikuar për pagesën familjare:

- refugjatët dhe personat me qëndrim të toleruar; me statusin e mbrojtjes së përkohshme ose mbrojtjes plotësuese
- personat me leje vendosjeje
- personat me qëndrim afatgjatë të KE-së

Pagesa familjare është kryesisht një pagesë për fëmijën dhe jepet derisa fëmija arrin moshën 18 vjeç (21 nëse ai/ajo vazhdon studimet). Pagesa të tjera jepen në rast të:

- lindjes,
- lejes së lindjes,
- familjeve me disa fëmijë,
- paaftësisë së fëmijës,
- fillimit të vitit shkollor,
- shkollimit të fëmijës jashtë vendit të zakonshëm të qëndrimit.

## **10. Strehimi**

Pagesa e strehimit mund t'u jepet personave që përmbushin disa kritere për të ardhurat e ulëta.

Një i huaj mund të aplikojë për strehim social me të njëjtat kushte si një shtetas polak, nëse situata materiale e tij/saj është e dobët dhe nëse ai/ajo nuk ka një banesë. Çdo komunitet lokal mund të specifikojë në vendimin e tij se kujt do t'i ofrohet banesa sociale. Strehimi social i jepet, së pari, atij personi që ka situatën materiale më të vështirë, pasi është dëbuar nga banesa ose e ka humbur atë për shkak të një fatkeqësie natyrore (përmbytjeje ose zjarri).

## **11. Njohja e diplomave**

Sipas *Rregullores së Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës për Njohjen e Certifikatave Shkollore dhe Certifikatave të Pjekurisë të Përtuara Jashtë (6 prill 2006)* dhe ndonjë certifikate shkolle të marrë jashtë duhet të legalizohet në vendin në të cilin është lëshuar dhe më pas të dorëzohet pranë autoritetit arsimor vendor (*kuratorium ośięaty*) në Poloni në mënyrë që të njihet.

Diplomat e huaja që japin mundësi për të ndjekur arsimin e lartë jashtë njihen në Poloni si certifikatat e tjera shkollore. Megjithatë, ato duhet të përmbajnë një dispozitë që vërteton se këta persona kanë mundësinë për të ndjekur institucionet e arsimit të lartë në vendet e tyre. Nëse certifikata nuk përmban një dispozitë të tillë, autoritetet e shkollës lëshojnë një certifikatë që mund të ketë një paragraf të veçantë që vërteton këtë fakt.

Personat me diploma të huaja të arsimit të lartë duhet të aplikojnë pranë këshillit të fakultetit (ose pranë një njësie tjetër bazë organizative të institucionit polak të arsimit të lartë). Institucioni i arsimit të lartë tek i cili duhet të aplikojnë, duhet të zgjidhet ndërmjet atyre që kanë të drejtën të japin diplomën akademike *doktor* në një fushë të caktuar të shkencës.

Diplomat e huaja shkencore njihen në Poloni në bazë të *Rregullores së Ministrisë të Arsimit dhe Sportit Kombëtar për njohjen e diplomave akademike dhe diplomave në fushën e artit të lëshuara jashtë (3 qershor 2005)* – në fuqi që nga 29 qershori 2005. Procedura e njohjes është e ngjashme me atë të diplomave të arsimit të lartë. Organet që mund t'i njohin diplomat akademike janë këshillat e fakulteteve, të cilat kanë të drejtën të japin diplomën *doktor habilitowany*.

Sa më sipër nuk gjen përdorim për certifikatat e lëshuara në vendet të cilat kanë nënshkruar marrëveshje dypalëshe për njohjen e dokumenteve arsimore me Poloninë (Austria, Gjermania, Lituania, Bjellorusia, Ukraina).

Për më shumë informacion, ju lutemi të shikoni Agjencinë Polake për Njohjen Akademike dhe Shkëmbimin Ndërkombëtar <http://www.buwim.edu.pl/>

## 12. Shërbimet e mbështetjes që u ofrohen migrantëve

### **Office for Foreigners** (Urząd do spraw Cudzoziemców) (Zyra për të Huajt)

Koszykowa 16 00-564 Warszawa

tel. 0 22 601 74 02

fax 0 22 601 74 13

<http://www.udsc.gov.pl/>

### **Caritas Polska – Migrant and Refugee Support Centres** (Karitasi Polak – Qendrat e Mbështetjes për Migrantët dhe Refugjatët)

43-200 Białystok, ul. Warszawska 32 tel/fax.: (85) 732 55 53

e-mail: [migranci-bialystok@caritas.pl](mailto:migranci-bialystok@caritas.pl)

20-950 Lublin, ul. Prymasa Stefana Wyszyńskiego 2 tel.: (81) 743 71 86

e-mail: [migranci-lublin@caritas.pl](mailto:migranci-lublin@caritas.pl)

59-900 Zgorzelec, ul. Księdza Domańskiego 12 tel.: (75) 771 65 61

e-mail: [migranci-zgorzelec@caritas.pl](mailto:migranci-zgorzelec@caritas.pl) 00-322

Warszawa, ul. Krakowskie Przedmieście 62 tel/fax.: (22) 826 99 10

e-mail: [migranci-waw@caritas.pl](mailto:migranci-waw@caritas.pl)

69-100 Słubice, ul. Wojska Polskiego, tel. (95) 737 40 06,

e-mail: [migranci-slubice@caritas.pl](mailto:migranci-slubice@caritas.pl)

### **Polish Humanitarian Action – Refugee Support Centre** (Veprim Humanitar Polak – Qendra për Mbështetjen e Refugjatëve)

00-031 Warszawa, Szpitalna 5/3

tel.: (22) 828 88 82; fax.: (22) 831 99 38, 828 88 82 w.217

e-mail: [ucho@pah.org.pl](mailto:ucho@pah.org.pl)

[www.pah.org.pl/uchodzczy](http://www.pah.org.pl/uchodzczy)

### **Polish Red Cross** (Kryqi i Kuq Polak)

00-561 Warszawa, ul. Mokotowska 14 tel.: (22) 628 55 75; 621 36 25; fax.: (22) 628 41 68 e-mail: [info@pck.org.pl](mailto:info@pck.org.pl)

[www.pck.org.pl](http://www.pck.org.pl)

### **UNHCR Poland** (KLRKB Poloni)

00-556 Warszawa, al. Róż 2

tel.: (22) 628 69 30, 625 61 46; fax.: (22) 625 61 24, e-mail: [polwa@unhcr.ch](mailto:polwa@unhcr.ch)

[www.unhcr.pl](http://www.unhcr.pl)

### **IOM (International Organization for Migration)** (ONM – Organizata Ndërkombëtare për Migracionin)

ul. Mariensztat 8

00-302 Warszawa

Tel. (+48 22) 5389103

Fax (+48 22) 5389140

e-mail: [iomwarsaw@iom.int](mailto:iomwarsaw@iom.int)

**Orthodox Church Mercy Centre "Eleos"** (Qendra e Bamirësisë "Eleos" e Kishës Ortodokse)  
15-062 Białystok, ul. Warszawska 47 tel.: (085) 732 89 07 e-mail: uchodzczy\_ [eleos@op.pl](mailto:eleos@op.pl), [eleos@poczta.onet.pl](mailto:eleos@poczta.onet.pl)

**Association of Refugees in Poland** (Shoqata e Refugjatëve në Poloni)  
00-375 Warszawa, ul. Smolna 40 e-mail: [assref@hotmail.com](mailto:assref@hotmail.com) [www.republika.pl/assref](http://www.republika.pl/assref)

**Foundation "Rescue" ("Ocalenie")** (Fundacioni "Shpëtimi")  
Mokotowska street 14  
Warsaw  
tel.: 0 - 22 - 628 55 76  
e-mail: [ocalenie@wp.pl](mailto:ocalenie@wp.pl)

**Association for Migrant Care and Integration „Proxenia”** (Shoqata për Kujdesin dhe Integrimin e Migrantëve "Proxenia")  
02-647 Warszawa, ul. Bachmacka 4/5 fax.: 581 85 21 e-mail: [proxenia@wp.pl](mailto:proxenia@wp.pl)

**Halina Nieć Human Rights Association** (Shoqata e të Drejtave të Njeriut Halina Nieć)  
31-136 Kraków, ul. Sobieskiego 7/3  
tel/fax.: (12) 633 72 23  
e-mail: [office@niecassociation.org](mailto:office@niecassociation.org)  
[www.niecassociaton.org](http://www.niecassociaton.org)

**Helsinki Human Rights Foundation Poland** (Fundacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Poloni)  
00-018 Warszawa, ul. Zgoda 11  
tel.: (22) 828 69 96, 828 10 08, 556 44 40  
fax.: (22) 828 69 96, 556 44 50 lub 51  
e-mail: [hfhr@hfhrpol.waw.pl](mailto:hfhr@hfhrpol.waw.pl), [sekretariat@hfhrpol.waw.pl](mailto:sekretariat@hfhrpol.waw.pl)  
[www.hfhrpol.waw.pl](http://www.hfhrpol.waw.pl)

**Human Rights Legal Clinic of the Jagiellonian University** (Klinika Ligjore për të Drejtat e Njeriut e Universitetit Jagiellonian)  
30-197 Kraków, ul. Zygmunta Krasińskiego 18  
tel/fax: (012) 630 19 97  
e-mail: [office@juhrc.org](mailto:office@juhrc.org)  
[www.ujhrc.org](http://www.ujhrc.org)

**Legal Clinic – Student Legal Aid Centre at the Warsaw University Law Dept** (Klinika Ligjore – Qendra Studentore e Ndhmës Ligjore në Departamentin e së Drejtës, Universiteti i Varshavës)  
00-071 Warszawa, Krakowskie Przedmieście 26/28  
tel.: (22) 552 08 11; tel./fax: (22) 552 43 18  
e-mail: [klinika@wpia.uw.edu.pl](mailto:klinika@wpia.uw.edu.pl)  
[www.klinika.wpia.uw.edu.pl](http://www.klinika.wpia.uw.edu.pl)

**Association „One World”** (Shoqata "Një Botë")  
Polish branch of Service Civil International  
60-830 Poznań, ul. Krasińskiego 3a/1  
tel.: (61) 848 43 38 fax.: (61) 848 43 37  
e-mail: [info@jedenswiat.org.pl](mailto:info@jedenswiat.org.pl)  
[www.jedenswiat.org.pl](http://www.jedenswiat.org.pl)

**A-venir Foundation:** (Fundacioni A-venir)  
ul. Wojciechowska 7J, 20-704 Lublin  
tel: 81 444 63 88, fax: 81 444 63 86;

ul. Warszawska 43, 15-062 Białystok  
tel: 085 740 72 88, fax: 085 740 72 88  
e-mail: [fundacja@a-venir.org.pl](mailto:fundacja@a-venir.org.pl),  
[www.a-venir.org.pl](http://www.a-venir.org.pl)

**Rule of Law Foundation** (Fundacioni i Shtetit Ligjor)

ul.F.Chopina 14/70, 20-023 Lublin

tel: 081 743 68 05

e-mail: [fundacja@fipp.org.pl](mailto:fundacja@fipp.org.pl)

[www.fipp.org.pl](http://www.fipp.org.pl)

**Foundation for Social Integration and Enterprise Development „Via”** (Fundacioni “Via”për Integrimin Shoqëror dhe Zhvillimin e Sipërmarrjeve)

ul. Długa 44/50 lok. 204, 00-241 Warszawa

tel: 022 635 54 79, 022 6356658 fax: 022 635 55 76

e-mail: [fundacja@via.org.pl](mailto:fundacja@via.org.pl) , [biuro@via.org.pl](mailto:biuro@via.org.pl)

[www.via.org.pl](http://www.via.org.pl)

**„H.A.I” COM Migrant Support** (Mbështetja e Migrantëve „H.A.I” COM)

Al. Jerozolimskie 91/11 02-001 Warszawa

tel./faks: 022 629 67 13, 0502 225 734, 0505 179 085, 0503 353 778

e-mail: [biuro@hai.com.pl](mailto:biuro@hai.com.pl)

[www.hai.com.pl](http://www.hai.com.pl)

**Migrant Centre Fu Shenfu** (Qendra e Migrantëve Fu Shenfu)

ul. Ostrobramska 98, 04-118 Warszawa

tel: 022 610 02 52

e-mail: [osrodek@migrant.pl](mailto:osrodek@migrant.pl)

**Emigrant Association** (Shoqata e emigrantëve)

Adres korespondencyjny: ul. Pogodna 12, 42-202 Częstochowa,

Biuro: ul. Pułaskiego 4/6,42-200 Częstochowa

tel: 034 368 42 98, 603 800 058

e-mail: [info@emigrant.net.pl](mailto:info@emigrant.net.pl)

[www.emigrant.net.pl](http://www.emigrant.net.pl)

**13. Marrja e nënshtetësisë**

Ju mund të aplikoni për nënshtetësi polake pas pesë vjetësh qëndrimi të vazhdueshëm mbi bazën e lejes së vendosjes, lejes së qëndrimit afatgjatë të KE-së ose lejes së qëndrimit të përhershëm. Bashkëshorti/ja e një shtetas polak mund të aplikojë për shtetësinë polake pas tre vjetësh martesë dhe nëse ka leje vendosjeje, leje qëndrimi afatgjatë të KE-së ose leje qëndrimi të përhershme. Aplikimet për nënshtetësinë duhet t'i drejtohen autoritetit vendor (Voivode).

**14. Kontakte dhe informacion tjetër i nevojshëm**

Për një listë të ambasadave polake përkatëse ju lutemi të shihni seksionin 2 për vizat.

**Ambasada e Shqipërisë në Poloni**

Altowa 1, 02-386 Warsaw

**Tel:** +48 22 824 14 27

**Fax:** +48 22 824 14 26

**Email:** [embassy.warsaw@mfa.gov.al](mailto:embassy.warsaw@mfa.gov.al)

**Ambasada e Bosnje-Hercegovinës në Poloni**

Humańska 10, 00-789 Warszawa

**Tel:** (0-22) 856 99 35

**Seksioni Konsullor:** (0-22) 856 71 82, 881 12 48

**Fax:** (0-22) 848 15 21

**Ambasada e Kroacisë në Poloni**

10 Ignacego Krasickiego, 02-628 Warsaw

**Tel:** (0048 22) 844 2393, 844 39 94

**Fax:** (0048 22) 844 48 08

**Email:** [croemb@pol.pl](mailto:croemb@pol.pl), [croemb.warszawa@mvpei.hr](mailto:croemb.warszawa@mvpei.hr)

**Ambasada e Republikës së Maqedonisë në Poloni**

Królowej Marysienki 40, 02-954 Warsaw

**Tel:** 48 22 651 72 91

**Fax:** 48 22 651 72 92

**Email:** [ambrmwar@zigzag.pl](mailto:ambrmwar@zigzag.pl)

[www.ambasadarm.zigzag.pl](http://www.ambasadarm.zigzag.pl)

**Ambasada e Serbisë në Poloni**

Rolna 175 A/B, 02-729 Warszawa

**Tel:** (0-22) 628 51 61, 625 60 41

**Fax:** (0-22) 629 71 73

**E-mail:** [embassy.warsaw@mfa.gov.yu](mailto:embassy.warsaw@mfa.gov.yu)

**Seksioni Konsullor:** (0-22) 628 51 61